



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202002116/2

Tiranë ____/____/2020

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisariatit të Policisë Kurbin.*

Drejtuar: **Z. Erdit ROÇEKU**
Shef i Komisariatit të Policisë Kurbin

LAC

Për dijeni: **Drejtues i parë Zef LASKA**
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë

LEZHË

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisariatit të Policisë Kurbin.

Inspektimi u krye në datën 30.06.2020, sipas Planit të Inspektimit, të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Hazbi Selita, dhe z.Besnik Deda, me detyrë Nd/Komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", në "Rregullat dhe Procedurat Standarde për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar dhe ndaluar në Njësitë Policore", miratuar me Urdhrin Nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, "Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", dhe në "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit Nr.306, datë 31.03.2016, si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë konkluzionet përfundimtare, duke ju referuar si më poshtë vijon:

¹ Neni 81 i ligjit nr. 81/2020, datë 25.06.2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i punës u takua me z.Plarent Lleshaj, shefi i rendit dhe z. Pashk Përvataj, shefi i Seksionit të policimit në komunitet, në Komisariatin e Policisë Kurbin, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi mori informacionin e nevojshëm lidhur me inspektimin, grupi i punës inspektoi ambientet e shoqërimit, zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës, ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar. Gjatë inspektimit të zyrave të punonjësve të Komisariatit të Policisë Kurbin, nuk u konstatuan sende apo mjete të cilat mund të ekspozonin dhunë apo elementë për trajtim çnjerëzor dhe denigrues.

Gjithashtu, shefi i rendit Plarent Lleshaj, informoi grupin e punës, se institucioni i Komisariatit Kurbin, është dëmtuar rëndë nga tërmeti i nëntori 2019, dhe gjysma e godinës ka dalë jashtë përdorimit. Për këtë qëllim drejtuesit e institucionit në bashkëpunim me Ministrinë Brendshme, në ditët në vijim po shikonin mundësinë për të marrë një godinë me qira, deri në rindërtimin e Komisariatit të Policisë Kurbin. Sa më sipër na pohuan, se Qeveria Turke në kuadër të ndihmës, që do t'i japi shtetit shqiptar për dëmtimet e shkatuara nga tërmeti, do të rindërtoj të gjithë zonën përfshirë dhe Komisariatin Kurbin. Sipas informacioneve që morëm, projekti është gati dhe është në fazën e zbatimit për rindërtimin e gjithë zonës së dëmtuar nga tërmeti sipas standardeve bashkëkohore dhe legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, rezulton se:

- Ishte zbatuar rekomandimi për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhguese në korridorin e ambientit të shoqërimit.
- Ishte zbatuar rekomandimi për ndarjen e ambienteve të shoqërimit sipas kriterëve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orenditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, meshkuj dhe kryesisht për të miturit.

Ndërkohë, grupi inspektimit konstatoj se:

- Nuk ishte zbatuar rekomandimi për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.

Në përfundim të inspektimit grupi monitorues konstatoi se, megjithëse në Komisariatin e Policisë Kurbin ishin marrë disa masa për përmirësimin e standardeve lidhur me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të personave të arrestuar/ndaluar, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika të cilat do paraqiten konkretisht më poshtë:

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin ambienti i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” dhe Procedurave Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016.

Në këtë Komisariat kishte 3 (tre) dhoma shoqërimi, të cilat ndodheshin në hyrje të Komisarlatit të ndar nga godina. Dhomat e shoqërimit ishin të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të mitur², duke krijuar kushte për trajtim të përshtatshëm të të shoqëruarve.

Këto ambiente ishin me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrimin e të shoqëruarve, duke krijuar kushte për trajtim dinjitoz dhe garantimin e të drejtave që ju njeh ligji këtyre personave.

Ambientet ishin me sipërfaqe 5x4m² me hapësirë sipas standardeve për qëndrimin e personave të ndaluar apo arrestuar. Sipas informacionit të dhënë kapacitetet në këto ambiente ishte deri në 12 shtetas të shoqëruar për konflikt me ligjin.

Dhomat e shoqërimit nuk ishin të pajisura me tualete brenda apo ngjitur me to. Të shoqëruarit përdornin tualetin, i cili përdorej edhe nga punonjësit e policisë të këtij Komisarlati. Në korridorin dhe në dhomat e ambienteve të shoqërimit ishte instaluar sistem monitorimi me kamera për vëzhgimin e veprimeve që kryheshin nga punonjësit e policisë me të shoqëruarit.

Dhomat e shoqërimit kishin dritare të cilat lejonin ajrimin dhe ndriçimin natyral, si dhe kishin ndriçim nga rrjeti elektrik. Ato ishin të pastra nga ana higjenike, por kishte nevojë lyrje. Gjithashtu, dhomat ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Në lidhje me zbatimin e rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së veprimeve me personat e shoqëruar, në Komisarlatin e Kurbin, nuk kishte dhoma (zyra) për marrjen në pyetje/intervistimin e këtyre personave³.

Në kohën e kryerjes së inspektimit nuk kishte persona të shoqëruar dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë.

Grupi inspektimit u informua nga drejtuesit e Komisarlatit, në lidhje me masat e marra me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19, ata ishin të pajisur me maska, dhe disinfektues të sjellë nga Drejtoria Vendore Lezhë. Po ashtu, janë bërë 4 herë disinfektime nga Drejtoria në të gjithë ambientet e Komisarlatit gjatë periudhës mars-qershor. Në kuadër të masave, ishte vendosur edhe rregulli për të shmangur sa më shumë shoqërimet e shtetasve në komisarlate, por të kryheshin verifikimet në terren. Emrat e personave të infektuar shpërndahen nëpër komisarlate sipas vendbanimeve dhe monitoroheshin nga inspektorët e zonave kryesisht përmes telefonatave, duke u rikujtuar respektimin e rregullave të karantinimit.

² Kreu VI, pika 3 e Procedurave Standarde. “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

³ Kreu VI, pika 4/e të Procedurave Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, gjatë periudhes 01.01.2020 deri më 30.06.2020, ishin të shoqëruar dhe evindentuar në regjistër të shoqërimit 133 shtetas, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122/1 të ligjit për Policinë e Shtetit.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin nuk kishte ambiente të sigurisë dhe personat e arrestuar/ndaluar dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Lezhë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarlatin e Policisë Kurbin, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr. 1” konform me Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 306, dt. 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë, në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë⁴.

Në këtë Komisarlat kishte regjistër për personat e ndaluar/arrestuar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e shoqërimit të tyre për në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarlat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por nuk ishte evindentuar asnjë ankesë apo kërkesë.

Ambientet e intervistimit

Në Komisarlatin e Policisë Kurbin, oficerët e policisë gjyqësore i kryenin veprimet procedurale me shtetasit, në zyrat e punës së tyre. Këto zyra nuk ishin të monitoruara dhe ndërkohë në këtë organ nuk kishte ambiente të veçanta hetimi të monitoruara me kamera gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore.

Lidhur me këtë fakt Avokati i Popullit edhe në raportin e inspektimit të mëparshëm ka rekomanduar marrjen e masave për krijimin e një zyre të veçantë ku të merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin në këtë zyrë të sistemit të monitorimit me kamera. Por, konstatojmë se ky rekomandim nuk është plotësuar.

Avokati i Popullit, referuar standardeve ndërkombëtare⁵ e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,

⁴ *Kreu VII, Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

⁵ *“Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e*

pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Nga monitorimi që u bë në disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime proceduriale.

Ndihma juridike dhe psikologjike

Nga intervistimi i punonjësve të policisë rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit madhorë të cilët nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, atyre iu sigurohej mbrojtja me avokat.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin për në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Lezhë, për kryerjen e veprimeve proceduriale në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut. Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, sipas dispozitave të Kodit të Proçedurës Penale.

Ndërsa psikologu sigurohej nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, por dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore vendore. Gjatë verifikimit të regjistrave të personave të shoqëruar u konstatua se procedura e ndjekur nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Kurbin, ishte zhvilluar konform ligjit.

Në inspektim na pohua që ky Komisariat nuk kishte mjek në organikën e tij, por kur kishte nevoja shendetësore nga të ndaluarit të arrestuarit apo shoqëruarit, ata u dërgonin në Spitalin e Qytetit.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës dhe të ambientit të shoqërimit, si dhe në dhomat e shoqërimit të këtij Komisarati, ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në Nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjithashtu, grupi inspektimit u informua se karta e të drejtave të njeriut u jepet çdo personi të shoqëruar/ndaluar apo arrestuar, që në momentin e hyrjes në ambientet e Komisarariatit duke garantuar njohjen e të drejtave, që nga momentet e fillimit të privimit të lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon pa vonesë familjen e personit të ndaluar / arrestuar.

policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohej që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]

Sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për ndërtimin e plotë të godinës së Komisarariatit Kurbin sipas kriterëve të parashikuara në Procedurat Standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke krijuar ambiente të përshtatshme dhe bashkëkohore për shtetasit e ndaluar apo shoqëruar, në konflikt me ligjin.
2. Marrjen e masave të nevojshme për krijimin e zyrës së intervistimit, ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra.
3. Marrjen e masave për mirëmbajtjen e kushteve higjieno-sanitare dhe pastërtisë në ambientet e Komisarariatit të Policisë, si dhe lyrjes dhe dezinfektimit të vazhdueshëm të tyre.
4. Marrjen e masave, për kryerjen e intervistave me të miturit në konflikt me ligjin, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme të intervistimit, në bazë të gjendjes dhe nevojave të të miturit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA